



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 7, Dt. 11.06.2009

Per miratim te kerkeses, per marrje leje, per perdorim uji, prej burimit ujore te Prroit "Reza e Kolonjes" ne afersi te fshatit Picar, per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC-it Picar 1, prej subjektit "Peshku-Picar 1" sh.p.k, Gjirokaster.

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "**PESHKU-PICAR 1**" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per "Konçesionet", vendimit te K.M nr.27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt. 19.07.2002 te K.K.U-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-se, te K.B.U -se, udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, Vendimit nr.837, dt. 11.06.2008 te K.M "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per dhenien me konçesion te HEC-it "Picari 1".

Duke mare ne konsiderat kerkesen e shoqeris "Peshku-Picar 1" sh.p.k. si dhe marveshjen e dates 28.04.2009 lidhur mese M.E.T.E dhe shoqerise "Peshku-Picar 1" sh.p.k.

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

1- Miratimin e kerkeses te bere nga shoqeria " Peshku-Picar 1" sh.p.k, Gjirokaster per dhenje leje, "Per perdorim te ujit" per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it te "Picari 1", ne prroin "Reza Kolonje", me veper marrje ne vendin me koordinata .

$$X = 44\ 48\ 503 \quad Y = 41\ 91\ 890 \quad Z = 288.3\ m$$

2 - Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise, nepermjet HEC-it e Picar 1 do te jete $1\ m^3/\text{sek}$.

Vazhdon vendimi nr.7 data 11.06.2009

3 - Periudha e perdorimit te ujit do te jete gjate gjithë vitit, perjashto periudhen nga 1 Maj deri ne 31 Gusht te cdo viti, ku prurjeve te mesiperme te ujit, do tu zbriten sasia e ujit qe do te perdoret per ujitjen e kulturave bujqesore - 0.2 m^3/sec

4 - Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.

5- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"
Vezir METAJ



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

